



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:092936

Datë: 15.01.2025

Numri i dokumentit: 06710640

PAKR.nr.142/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - Departamenti për Krime të Rënda, kolegji i përbërë nga gjyqtarët Hashim Çollaku, kryetar i kolegjit, Kadrije Goga Lubishtani dhe Valbona Musliu Selimaj, anëtarë të kolegjit, me bashkëpunëtoren profesionale Jeta Asllani, në çështjen penale kundër të akuzuarit K.S për shkak të veprës penale Vrasje në tentativë nga neni 146 lidhur me nenin 20 të KPK-së, duke vendosur sipas ankesës së mbrojtëses së të akuzuarit K.S , Av. Fatmire Braha, të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë, Departamenti për Krime të Rënda, P.nr.506/2013, të datës 16.01.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 12.12.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e mbrojtëses së të akuzuarit K.S , Av. Fatmire Braha, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë, Departamenti për Krime të Rënda, P.nr.506/2013, i datës 16.01.2024, vërtetohet.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Mitrovicë, Departamenti për Krime të Rënda, me aktgjykimin P.nr.506/2013, të datës 16.01.2024, të akuzuarin K.S , e ka shpallur fajtor për veprën penale Vrasje në tentativë nga neni 146 lidhur me nenin 20 të KPK-së dhe i ka shqiptuar dënim me

burgim në kohëzgjatje prej një (1) vjet e gjashtë (6) muaj, i cili dënim do të ekzekutohet pasi që aktgjykimi të behet i formës së prerë.

Koha e kaluar në masën e arrestit shtëpiak nga data 15.09.2010 deri më datë 15.10.2010, të akuzuarit i është llogaritur në dënimin e shqiptuar me burgim.

I akuzuari është obliguar që të paguajë shpenzimet e procedurës penale ne lartësi prej pesëdhjetë (50) euro, paushallin gjyqësor ne lartësi prej njëzet (20) euro dhe ne emër te Fondit për Kompensimin e Viktimave të Krimit shumen prej pesëdhjetë (50) euro, të cilat është i obliguar që t'i paguajë në afatin prej 15 ditësh pasi që aktgjykimi te merr formën e prerë.

I dëmtuari B. B , për realizimin e kërkesës pasurore juridike, është udhëzuar në kontest të rregullt civil.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor kanë ushtruar ankesë:

Mbrojtësja e të akuzuarit K.S , Av. Fatmire Braha, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së ligjit penal dhe vendimit lidhur me sanksionin penal, me propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës të aprovojë ankesën si të bazuar, aktgjykimin e ankimuar ta anulojë dhe çështjen të kthejë në rigjykim dhe rivendosje, apo të ndryshojë aktgjykimin dhe ndaj të akuzuarit të shqiptojë aktgjykim lirues, ose në rastin më të pavoritshëm të ndryshojë aktgjykimin dhe të akuzuarit t'i shqiptojë dënim të kushtëzuar

Prokuroria e Apelit me parashtrësën PPA/I.nr.142/2024, të datës 07.03.2024 ka propozuar që të refuzohet si e bazuar ankesa e mbrojtëses së të akuzuarit K.S , Av. Fatmire Braha, ndërsa aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Në kuptim të nenit 390 të KPPRK-së Kolegji i kësaj gjykate ka caktuar seancën e kolegjit për datë 12.12.2024 dhe në mënyrë të rregullt i ka njoftuar të gjitha palët nga shkresat e lëndës.

Palët dhe pse janë njoftuar me kohë dhe në mënyrë të rregullt për kohën dhe vendin e mbajtjes së seancës, nuk prezantuan në seancë.

Gjykata e Apelit në kuptim të nenit 394 të KPPRK-së i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar dhe pasi vlerësoi pretendimet ankimore në ankesë gjeti se:

Ankesa e mbrojtëses së të akuzuarit K.S , Av. Fatmire Braha është e pabazuar.

Pretendimet ankimore të mbrojtëses së të akuzuarit

Mbrojtësja e të akuzuarit në ankesë pretendon se aktgjykimi i ankimuar është i pa arsyetuar, i pa argumentuar, i pa qëndrueshëm dhe i kundërligjshëm. Dispozitivi i aktgjykit të ankimuar është i paqartë, i pa kuptueshëm dhe nuk është në harmoni me vetveten si dhe me arsyetimin, sepse nuk përmban arsyet lidhur me faktet vendimtare, përkitazi me veprën penale me të cilën ngarkohet i akuzuari. Nga provat e administruara nuk janë vërtetuar faktet vendimtare që e karakterizojnë çështjen penale e sidomos nuk është vërtetuar dashja si element crucial i veprës penale të vrasjes në tentativë sepse e tërë ngjarja ka ndodhur në mes shokëve pas një lojë futbollit dhe ka ndodhur aty për aty dhe janë shkaktuar lëndime trupore të lehta të dëmtuarit që është vërtetuar nga ekspertiza mjekoligjore e ekspertit T. G e datës 04.02.2011 dhe se briskun qe ka poseduar i pandehuri ka qene për mprehje te lapsave për te pikturuar pasi i njëjti është marr dhe merret me pikturim.

Po ashtu sipas mbrojtjes aktgjykimi nuk është përpiluar në pajtim me nenin 369 par.6 dhe 7 të KPP-së e lidhur me nenin 364 par. 1, pika 1.1 të KPP-së, pasi që fillimisht dispozitivi i aktgjykimi për veprën penale Vrasje në tentativë nga neni 146 lidhur me nenin 20 te KPK-së që e ka shpallur fajtor nuk përmban të shënuara fare faktet e rrethanat që e përbejnë figurën e veprës penale.

Për më tepër, si pasojë e shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale në dëm të të akuzuarit është shkelur ligji penal komfor nenit 385 të KPP-së, kur e ka shpallur fajtor për veprën penale Vrasje në tentativë nga neni 146 lidhur me nenin 20 te KPK-së, ngase pretendimet e prokurorisë nuk kanë pasur mbështetje në prova konkrete të pranueshme në aspektin ligjor, sepse për tu plotësuar elementet- tiparet e figurës së veprës penale Vrasje në tentativë duhet që në veprimet e të akuzuarit të ekzistojë dhe vërtetohet qëllimi- dashja, çka prokuroria nuk ka arritur të argumentojë me prova konkrete, të mjaftueshme dhe bindëse se tek i pandehuri janë plotësuar elementet e figurës së veprës penale dhe se ka ekzistuar qëllimi- dashja e të akuzuarit.

Po ashtu, gjykata e shkallës së parë në arsyetimin e aktgjykimit nuk ka arsyetuar në mënyrë konkrete dhe individuale ashtu siç është e detyruar me ligj veprimet e të akuzuarit K.S në bazë të provave relevante të administruara në shqyrtimin gjyqësor, mirëpo pa paraqitur dhe përshkruar fare në arsyetim ashtu si është e obliguar në bazë të nenit 369 par.7 të KPP-së në mënyrë të qartë dhe të plotë faktet dhe për çfarë arsyesh i ka konsideruar si të vërtetuara këto fakte sa i përket të njëjtit, duke i përshkruar në mënyrë konkrete provat apo pjesën e provave ligjërisht të pranueshme mbi të cilat është bazuar.

Gjithashtu, sipas mbrojtjes Gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje të nenit 339 te KPP-së, pasi qe nuk ka ftuar fare ekspertin mjekoligjor Dr. T. G në shqyrtim gjyqësor dhe raporti të futet ne procesverbal. Eksperti përshkruan konstatimet dhe shpjegon analizat e tij, Gjithashtu për t'i bërë pyetje edhe palët në procedurë, pasi qe Gjykata ka mundur të ftojë edhe sipas detyrës zyrtare këtë ekspert me qëllim të vërtetimit të drejtë të gjendjes faktike respektivisht të natyrës së lëndimeve se a kanë mund të jenë vdekjeprurëse apo jo lëndimet që ka pësuar i dëmtuari në këtë rast, e rrethana dhe sqarime tjera të na jap eksperti mjekoligjor i cili e ka hartuar ekspertizën mjekoligjore të datës 04.02.2011.

Sipas mbrojtjes, në mungesë të vlerësimit të kualitetit të të gjitha provave relevante të administruara në shqyrtimin gjyqësor sa i përket përgjegjësisë penale që ka të bëjë me të pandehurin, nuk mund të përfundohet se gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë. Asnjëra nga provat nuk e inkriminon ne asnjë formë të pandehurin për veprën penale të vrasjes në tentativë ndërsa për veprën penale lëndim i lehtë trupor po, por duke pasur parasysh kohën e ndodhjes së rastit që më shumë se 13 vite ka parashkrim absolut të veprës penale lëndim i lehtë trupor.

Gjithashtu mbrojtja e ankimon aktgjykimin edhe sa i përket vendimit mbi dënimin, me arsyetimin se dënimi me burg në kohëzgjatje prej një (1) vit e gashë (6) muaj është shumë i lartë, duke pasur parasysh se si rast ka ndodh që mbi 13 vite dhe që gjatë kësaj kohe i akuzuari është dëmtuar psiqikisht, moralisht, ekonomikisht sepse gjykimi duhet të ndodh në kohë të arsyeshme e jo si në rastin konkret qe mbi 13 vite, si dhe gjatë kësaj kohe por as para dhe as pas këtij rasti nuk ka ra në kundërshtim me ligjin, mosha e re, vetëm 18 vjet në kohën e ndodhjes se rastit, raportet e mira me te të dëmtuarin e qe gjykata e shkallës së parë nuk i ka vlerësuar drejtë këto rrethana por e ka dënuar me dënim shumë të ashpër dhe me dënim burgu, pas 13 viteve të ndodhjes së rastit. I pandehuri ka ardhur nëpër seanca gjyqësore çdo herë, duke prit

epilog të kësaj çështje që e ka godit shumë rëndë sepse i njëjti është dëmtuar rëndë psiqikisht, gjithashtu edhe ekonomikisht pasi që siç cekem me lartë ka mbetur në evidencë penale lënda e pa kryer që më shumë se 13 vite dhe si pasojë e saj nuk ka mundur të punësohet. Fakti se i pandehuri nuk ka rënë në kundërshtim me ligjin as para dhe pas këtij rasti, vërteton faktin se nuk është recidivist i veprave penale. I pandehuri ka shprehur keqardhje të thellë për këtë rast që ka ndodh dhe që i ka shkaktuar lëndime të lehta trupore të dëmtuarit, por kanë qenë të ri dhe ka ndodh aty për aty, pas një loje futbolli që kanë pasur mes veti, me të dëmtuarin B. B janë pajtuar dhe kanë raporte të mira edhe para këtij rasti edhe pas këtij rasti, gjë që ka deklaruar edhe vetë i dëmtuari në shqyrtimin gjyqësor të datës 12.09.2023 dhe nuk kanë asgjë të keqe. Dënimi me burg në kohëzgjatje prej një (1) Vit e gjashtë (6) muajve është jo i drejtë, shumë i ashpër dhe si i tillë nuk mund të justifikohet duke patur parasysh se nga të lartcekurat aktgjykimi i atakuar përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, çfarë ka pasur për pasojë edhe shkeljen e ligjit penal në dëm të njëjtit dhe se gjendja e fakteve është vërtetuar në mënyrë të gabuar dhe jo të plotë, ashtu që komfor nenit 363 par. 1 pika 1.3 të KPP, i akuzuari K.S duhet që të shpallet i pafajshëm.

Vlerësimi i Gjykatës së Apelit

Kolegji penal i kësaj gjykate vlerëson se pretendimet e mësipërme ankimore të mbrojtëses së të akuzuarit K.S , Av. Fatmire Braha, sa i përket shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale nuk qëndrojnë, e gjithashtu nuk ka shkelje tjera të dispozitave të procedurës nga neni 384 të KPPRK-së, për të cilat shkelje kjo gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare, e të cilat do të kushtëzonin anulimin e këtij aktgjykimi.

Dispozitivi i aktgjykimit është i qartë, i kuptueshëm dhe në harmoni të plotë me arsyetimin, ndërsa në arsyetim janë dhënë arsye të qarta dhe të plota lidhur me faktet vendimtare të cilat vërtetojnë se në veprimet e të akuzuarit janë formësuar elementet e veprës penale Vrasje në tentativë nga neni 146 lidhur me nenin 20 të KPK-së.

Kjo gjykatë vlerëson se Gjykata e shkallës së parë ka analizuar të gjitha provat e procedura gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe lidhur me këto prova ka paraqitur konkludimet e saj, e të cilat si të drejta, objektive dhe të ligjshme, i vlerëson edhe kjo gjykatë. Gjykata e shkallës së parë, vlerësimin e provave e ka bërë në pajtim me dispozitat ligjore, duke dhënë arsye të qarta dhe konkrete për vendin, kohën dhe mënyrën se si ka ardhur deri të kryerja e veprës penale nga ana e të akuzuarit.

Gjithashtu, sa i përket pretendimit të mbrojtjes se gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje të dispozitave të procedurës penale pasi që në seancën e shqyrtimit gjyqësor nuk ka ftuar ekspertin mjekoligjor T. G , i cili ka përpiluar ekspertizën mjekoligjore të datës 04.02.2011, për të shpjeguar konstatimet e tij me qëllim të vërtetimit të drejtë të gjendjes faktike, Kolegji penal i kësaj gjykate vlerëson se ky pretendim është i pabazuar pasi që ekspertiza mjekoligjore është administruar si provë nga gjykata e shkallës së parë në shqyrtimin gjyqësor të datës 12.12.2023 dhe asnjëra nga palët nuk kanë pasur vërejtje sa i përket kësaj prove, ashtu që në të njëjtën ekspertë ka konstatuar në mënyrë të qartë natyrën e lëndimeve trupore të shkaktuara palës së dëmtuar. Për më tepër për veprën penale vrasje në tentativë për të cilën i akuzuari është shpallur fajtor nuk është element i veprës lloji i lëndimit trupor të cilin e ka pësuar i dëmtuari, por element i kësaj veprë është qëllimi dhe dashja e të akuzuarit që të dëmtuarin të privojë nga jeta.

Sa i përket pretendimeve ankimore përkitazi me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, Gjykata e Apelit e Kosovës konstaton se këto pretendime nuk qëndrojnë dhe Gjykata e shkallës së parë gjendjen faktike në këtë çështje penale e ka vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, për shkak se nga provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor është vërtetuar se i akuzuari K.S është kryes i veprës penale Vrasje në tentativë nga neni 146 lidhur me nenin 20 të KPK-së, për të cilën është shpallur fajtor.

Nga provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor është vërtetuar se i akuzuari K.S me datë 15.09.2010, rreth orës 01:10 minuta të mesnatës, në Vushtrri, në Rr. "...", në parkingun e automjeteve tek stadiumi i futbollit "Forca", me dashje ka tentuar që të privojë nga jeta të dëmtuarin B. B në atë mënyrë që, pas një loje futbollit të zhvilluar në sallë ka shpërthyer një rrahje mes të akuzuarit dhe B. H por është ndërprerë nga ndërhyrja e të pranishmëve, por e njëjta ka vazhduar më pas në dalje të stadiumit ku i pandehuri fillon të rrihet me B. H dhe në ato momente i ndërhyr i dëmtuari B. B për t'i ndarë dhe fillimisht i dëmtuari e godet me boks të akuzuarin në fytyrë dhe i pandehuri pasi merr një thikë nga çanta e tij, me të e godet të dëmtuarin B katër herë në pjesën e pasme të shpinës dhe atë: një herë në supin e majtë, dy herë të tjera në krahëror prapa nën shpatullën e majtë dhe një plagë tjetër prerëse – shpuese shkuese në zonën ijore të majtë, por vepra ka mbetur në tentativë pasi me të shpejtë kanë ndërhyrë shokët e tyre dhe i kanë ndarë dhe të dëmtuarin B e dërgojnë në Qendrën Emergjente në Vushtrri, me cka i demtuari ka pësuar lëndime të lehta trupore në kufirin e sipërm të tyre.

Deri të kjo gjendje faktike, Gjykata e shkallës së parë kishte ardhur pas administrimit të provave personale, konkretisht në cilësinë e dëshmitarit është dëgjuar i dëmtuari B. B , pastaj janë dëgjuar edhe dëshmitarët: A. F , E. T dhe L.P , janë lexuar procesverbali i intervistimit të dëshmitarit A. H të dhënë në Polici dhe procesverbali i intervistimit të dëshmitarit Besfort Maxhuni të dhënë në polici. Ndërsa janë administruar si prova materiale Raporti i hetuesit policor mbi vendin e ngjarjes, i datës 15.09.2010, Raporti i oficerit i datës 15.09.2010, Raporti i këqyrjes së vendit të ngjarjes i datës 15.09.2010, nga Njësia e Forenzikës, Fotoalbumi nga vendi i ngjarjes, Raporti mjekësor i datës 15.09.2010 në emër të të dëmtuarit B. B , me numër të protokollit 353, lëshuar nga Emergjenca në QKMF- Vushtrri, Ekspertiza mjekoligjore e ekspertit T. G , e datës 04.02.2011, për lëndimet e pësuar të dëmtuarit B. B .

Andaj pretendimet e mbrojtëses së të akuzuarit se Gjykata e shkallës së parë nuk e ka vërtetuar në mënyrë të plotë gjendjen faktike pasi që asnjë nga provat e administruara nuk e inkriminon të pandehurin në drejtim të veprës penale vrasje në tentativë, por lëndim i lehtë trupor janë pretendime të pabazuara, sepse nga provat personale dhe materiale të administruara gjykata e shkallës së parë drejt ka vërtetuar gjendjen faktike se i pandehuri K ditën kritike kishte ndërmarr veprime në drejtim të privimit nga jeta të dëmtuarit B. B . Se i pandehuri ka pasur qëllim që të dëmtuarin ta privojë nga jeta vërtetohet me vet faktin se i njëjti me dashje e kishte goditur të dëmtuarin katër herë me thikë duke i shkaktuar plagë dhe atë një plagë në supin e majtë, dy plagë të tjera në krahëror prapa nën shpatullën e majtë dhe një plagë tjetër prerëse – shpuese shkuese në zonën ijore të majtë, dhe nga këmbëngulja e tij vërtetohet dashja e tij për të privuar nga jeta të dëmtuarin. Po ashtu, dashja e të pandehurit për të privuar nga jeta është vërtetuar edhe nga fakti se i dëmtuari nuk ka pasur në dorë ndonjë mjet të fortë ose mjet të rrezikshëm, gjë që ka qenë krejtësisht i pambrojtur, gjersa është goditur në pjesë vitale të trupit nga i pandehuri, ashtu që i pandehuri ka qenë i vetëdijshëm se me veprimin e tij, goditjen me thikë ndaj të dëmtuarit do të shkaktonte pasojën e ndaluar, por që vepra ka mbetur në tentativë.

Andaj, Gjykata e Apelit e Kosovës duke u bazuar në të gjitha këto që u thanë më lart, vlerëson se Gjykata e shkallës së parë drejt dhe në mënyrë të plotë e ka vërtetuar gjendjen faktike dhe në këtë çështje penale nuk ka mbetur pa u vërtetuar asnjë fakt vendimtar.

Kolegji penal i kësaj gjykate i vlerëson si të pabazuara pretendimet e mbrojtjes lidhur me shkeljen e ligjit penal, pasi nuk ekzistojnë asnjë nga rrethanat që parashihen me dispozitat e KPPRK-së të cilat konsiderohen shkelje e ligjit penal, në veprimet e të akuzuarit formësohen të

gjitha elementet subjektive dhe objektive të veprës penale për të cilën i njëjti është shpallur fajtor, si dhe nuk ekzistojnë rrethana të cilat e përjashtojnë përgjegjësinë penale apo ndjekjen penale të të akuzuarit.

Sa i përket pretendimeve ankimore të mbrojtësit të akuzuarit lidhur me vendimin mbi dënimin, kjo gjykatë i vlerëson si të pabazuara. Gjykata e shkallës së parë me rastin e shqiptimit të llojit dhe lartësisë së dënimit ka marr parasysh dhe ka vlerësuar drejt të gjitha rrethanat të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit. Si rrethanë lehtësuese gjykata vlerësoi moshën e re të akuzuarit në kohën e kryerjes së veprës penale, pasi që atëherë i njëjti kishte vetëm 18 vjet, pastaj faktin se nga verifikimi në Sistemin Qendror të Evidencës Penale, ka rezultuar se i akuzuari nuk është dënuar me parë me aktgjykim te formës së prerë për kryerjen e ndonjë vepre tjetër penale, pastaj kohën relativisht të gjatë nga kryerja e veprës penale, faktin se të njëjtit nuk kanë raporte të këqija edhe pas kryerjes së veprës penale, ndërsa si rrethana rënduese gjykata kishte parasysh dhe vlerësoi intensitetin e rrezikimit apo te dëmtimit te vlerës se mbrojtur, ngase ne rastin konkret i dëmtuari ishte goditur katër herë nga i pandehuri me thikë dhe si rezultat ka pësuar lëndime të lehta trupore.

Një vlerësim të këtillë të rrethanave relevante për matjen e dënimit si të drejtë dhe të ligjshëm e pranon edhe kjo gjykatë dhe gjen se Gjykata e shkallës së parë drejt dhe në mënyrë të plotë i ka vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit. Ndërsa, pretendimin e mbrojtësit se dënimi është jo i drejtë, kjo Gjykatë e vlerëson si të pabazuar pasi që të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese kanë qenë objekt vlerësimi nga Gjykata e shkallës së parë dhe pikërisht si rezultat i këtyre rrethanave edhe i është shqiptuar dënimi përkatës nën minimumin e paraparë ligjor, andaj të gjitha këto rrethana sipas vlerësimit të Kolegjit penal të kësaj gjykate japin bazë të mjaftueshme që arsyetojnë shqiptimin e dënimit nga Gjykata e shkallës së parë si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar.

Prandaj, kjo gjykatë vlerëson se dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit nga ana e Gjykatës së shkallës së parë është në harmoni me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale të kryer dhe shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit, intensitetin e rrezikimit apo pasojave të shkaktuara dhe se me të do të parandalohet i pandehuri nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, si dhe do të parandalohen personat tjerë nga kryerja e veprave penale.

Nga arsyet e sipërcekura, e në bazë të nenit 401 të KPPRK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA

PAKR.nr.142/2024

Datë: 12.12.2024

Bashkëpunëtorja Profesionale

Anëtarët e kolegjit

Kryetar i kolegjit

Jeta Asllani

Kadrije Goga Lubishtani

Hashim Çollaku

Valbona Musliu Selimaj